



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkojmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: z. Gazmend Muhaxheri, Kryetar

Adresa: Rr. Hasan Prishtina / Objekti i Komunës, Pejë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Pejës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Pejës (KP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Pejës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Pejës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Pejës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Në katër raste OJQ-të të cilat ishin përzgjedhur për subvencionim (vlera totale e subvencioneve ishte 21,000€) kishin obligime të pashlyera ndaj ATK-së, ndërsa tri nga këto OJQ nuk kishin ofruar dëshmitë mbi mbylljen e projektit nga viti 2019.
- B1 Në katër raste komuna nuk kishte hartuar projekt ekzekutiv, por kishte iniciuar proceduarat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarin.
- B2 Në 13 raste faturat/obligimet në vlerë totale 552,196€ ishin paguar pas afatit kohore ligjor prej 30 ditësh.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i Çështjes

- 1 Komuna bazuar në vendimet gjyqësore/përmbartimore kishte kryer dy pagesa në vlerë totale prej 21,682€ në kategori ekonomike jo adekuate. Pagesat ishin për pagat përcjellëse, dalje në pension si dhe për pagesën e shujtës për punëtorët e arsimit. Këto pagesa ishin realizuar nga kategoria mallra dhe shërbime, përkundër faktit që këto shpenzime për nga natyra i takojnë kategorisë paga dhe mëditje.

Duke qenë se çështja në fjalë është mjaft e përhapur në shumë organizata buxhetore dhe po përsëritet për vite me radhë, ajo do të trajtohet më hollësisht në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Pejës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Pejës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Pejës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Pejës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Pejës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Thirrja publike, vlerësimi dhe monitorimi i subvencioneve në kundërshtim me rregulloren

Gjetja Gjatë procesit të subvencionimit të përfituesve vërejtëm këto dobësi/parregullësi:

1) Rregullorja MF-Nr.04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve, neni 13, përcakton kriteret të cilat duhet ti përmbajë⁶ thirrja publike.

Me dt.16.03.2020 Komuna kishte shpallur thirrje publike për subvencionim të OJQ/Klubeve ku ndër kriteret e vendosura ishin: dëshmitë që OJQ-të nuk kanë obligime ndaj ATK-së dhe dëshmitë mbi mbylljen e projekteve paraprake.

Thirrja publike e cekur më lartë nuk ishte në përputhje me rregulloren për subvencionim pasi që nuk përmbante Formularin 9/projekt-propozimin, Formularin 10/projekt buxhetin, dhe të dhëna për kalendarin tentativë të realizimit të thirrjes.

Në katër raste OJQ-të të cilat ishin përzgjedhur për subvencionim (vlera totale e subvencioneve ishte 21,000€) kishin obligime të pashlyera ndaj ATK-së, ndërsa tri nga këto OJQ nuk kishin ofruar dëshmitë mbi mbylljen e projektit nga viti 2019.

Shkak i kësaj ishte papërgjegjësia e zyrtarëve kompetent të cilët nuk kanë marrë parasysh kërkesat e rregullores me rastin e thirrjes publike për subvencionim të OJQ-ve dhe vlerësimin e aplikacioneve.

2) Po ashtu, sipas nenit 23.1 të rregullores së njejtë Monitorimi dhe raportimi i projekteve dhe programeve përcakton se “Për secilën kontratë të lidhur, ofruesi i mbështetjes financiare cakton një zyrtar përgjegjës i cili duhet kujdeset për monitorimin e implementimit të projektit. Ndërsa në pikën 2 kërkohet nga përfituesi të raporton te zyrtari monitorues, në baza të rregullta, lidhur me zbatimin e projektit/programit, sipas kërkesave të kontratës.

Në gjashtë raste kemi konstatuar se përfituesit e subvencioneve nuk ka dorëzuar raporte kthyesë narrative, kurse tre (3) pre tyre nuk kanë dorëzuar raporte financiare.

Shkak i kësaj ishte neglizhenca e menaxhmentit të Komunës për të caktuar zyrtar monitorues, dhe mos caktimi i një afati kohor të raportimit në kontrata.

Ndikimi Thirrja publike për subvencionim të OJQ-ve dhe përzgjedhja e përfituesve në kundërshtim me rregulloren dhe kriteret e vendosura si dhe mos monitorimi i subvencioneve rrit rrezikun që mjetet buxhetore të ndahen dhe shpenzohen në kundërshtim me objektivat e Komunës.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të siguroj që thirrjet publike për subvencionim të përmbajë të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregulloren mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve, pastaj ndarja e subvencioneve të bëhet në përputhje me kriteret e vendosura si dhe për çdo përfitues të subvencionit të caktojë zyrtar monitorues.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mungesa e projekteve ekzekutive

Gjetja Neni 20 pika 10 i Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (UOPP) kërkon që "Specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten". Ndërsa pika 13 "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet specifikave teknike të cilat janë pjesë e dosjes së tenderit". Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Në katër⁶ raste komuna nuk kishte hartuar projekt ekzekutiv, por kishte iniciuar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarin. Në dy prej tyre tek pozicionet e para të paramasës ishte paraparë që operatori ekonomik fitues të hartoj projektin ekzekutiv dhe të bëjë vlerësimin e ndikimit në mjedis pas nënshkrimit të kontratës.

Sipas zyrtarëve shkak i kësaj ishte mungesa e mjeteve buxhetore si dhe arsytimi se zhvillimi i procedurave për kontraktimin e një OE për hartimin e projekteve do të shkaktonte vonesa në iniciimin e procedurave tek projektet kapitale.

Ndikimi Realizimi i investimeve kapitale pa projekte ekzekutive, rritë rrezikun e realizimit të punëve pa kriteret standarde të ndërtimit (që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurinë e shfrytëzuesve, mbrojtjen e ambientit, trashëgimisë dhe pronës) dhe vonesa në realizimin e tyre që mund të shoqërohen me kosto shtesë. Kurse punimi i paramasës se projekteve ekzekutive nga OE rrit rrezikun që punët mos të kryhen sipas kërkesave të njësisë kërkuese të Komunës.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të siguroj kontrole dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore që me rastin e kontraktimit të punëve duhet të hartohen paraprakisht projektet ekzekutive në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara të njësisë kërkuese.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Vonesa në pagesën e faturave të papaguara

Gjetja Neni 39 i LMFPP përcakton ZKF-në e organizatës buxhetore përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagesë.

Në 13 raste faturat/obligimet në vlerë totale 552,196€ ishin paguar pas afatit kohorë ligjor prej 30 ditësh, vonesat variojnë nga 35 deri 286 ditë

kalendarike.

Sipas zyrtarëve kjo gjendje është krijuar në mungesë të mjeteve buxhetore.

Ndikimi

Vonesat në pagesa mund të ndikojë në rritjen e obligimeve të cilat krijojnë implikime buxhetore për vitin vijues dhe rrezikojnë të shkaktohen shpenzime shtesë për shkak mundësisë së pagesave sipas vendimeve gjyqësore/përmbartimore.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të ngritë kontrolle shtesë për tu siguruar se të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda afatit të paraparë ligjor me qëllim të menaxhimit të obligimeve të papaguara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Të hyrat

Komuna për vitin 2020 kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 4,349,600€, nga të cilat ishin realizuar 3,460,290€ apo 80%. Këto të hyra janë kryesisht nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga licencat, qiraja etj. Përveç këtyre të hyrave komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat grumbullohen nga niveli qendror (gjobat nga policia, gjykata dhe agjensioni i pylltarisë) në vlerë prej 678,040€.

Çështja A2 - Mangësi në bazën e të dhënave për tatimin në pronë

Gjetja

Neni 11 paragrafi 1 i Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronë të Paluajtshme përcakton që: Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohet zbritja prej pesëmbëdhjetë mijë (15,000) euro nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit, si dhe paragrafi 4 përcakton që: Personi fizik i cili ka në pronësi apo posedim dy (2) ose më shumë njësi rezidenciale të objekteve, mund të deklarojë në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, vetëm një prej këtyre objekteve si vendbanimin e tij parësor, pa marrë parasysh faktin që njësitet e objekteve mund të ndodhen në komuna të ndryshme.

Bazuar në kërkesat e sistemit Protax, kartela e tatimpaguesit duhet të përmbajë elementet si në vijim: numrin personal ID, numrin e tatimpaguesit, pronës, ndërtesës, fotografi etj.

Nga mostrat e testuar dhe analiza e bazës së shënimeve të Protax-it, kemi konstatuar se numri i tatimpaguesve që përfitojnë nga zbritja pa e pasur kartelën e kompletuar është 5,295, ku 2,589 prej tyre nuk kanë të vendosur numrin e letërnjoftimit, 2,681 kanë të vendosur numra që nuk korrespondojnë me numër të letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, ndërsa 25 tatimpagues janë përfitues në dy vendbanime parësore.

Shkaku i ndodhjes është neglizhenca e zyrtarëve kompetent për kompletimin e dosjeve të tatimpaguesve.

Ndikimi

Mangësitë e identifikuar në bazën e të dhënave dhe informatat e mangëta në dosjen e tatimpagueseve përfshirë numrin personal, ndikon në mundësin e përfundimit të zbritjes së vendbanimit parësor në më shumë se një pronë.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të siguroj se dosjet e tatimpaguesve janë kompletuar bazuar në kërkesat e sistemit Protax.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mos verifikimi i gjendjes aktuale të pronave

Gjetja Sipas nenin 15 të pikës 2 të Ligjit nr.06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme, Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha pronave brenda territorit të Komunës.

Nga 28,850 prona të evidentuara në bazën e të dhënave, komuna për vitin 2020 kishte planifikuar të verifikoj 8,226 apo 29% të pronave, mirëpo komuna kishte arritur të verifikoj vetëm 860 apo 3%.

Verifikimi jo i plotë kishte ndodhur për shkak që zyrtarët komunal kishin pasur probleme me lëvizjet për shkak të pandemisë Covid-19.

Ndikimi Verifikimi jo i plotë i pronave për qëllime të tatimit në pronë, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte 4,667,793€, prej tyre ishin shpenzuar 4,132,109€ apo 89% e buxhetit, këto shpenzime ishin kryesisht për shërbime kontraktuese, mirëmbajtje dhe riparime, për blerje të mobilieve dhe pajisjeve, vendime të gjykatave, derivate si dhe telekomunikimit dhe përfaqësimit. Përderisa, buxheti final për shërbimet komunale ishte 757,688€ i cili ishte shpenzuar në masën prej 96% e buxhetit. Kemi testuar 21 mostra për teste substanciale në vlerë 203,626€ si dhe shtatë (7) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A4 - Shpërblimi me kontratë pa i plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit

Gjetja

Neni 59 paragrafi 4 i LPP-së thekson se Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Në dy dosje të tenderit - mes tjerash - tek pjesa kapaciteti ekonomik dhe financiar ishte kërkuar që OE të ofrojnë dëshmi - pasqyrat financiare të audituara për 3 (tri) vitet e fundit dhe raportin e audituar për pasqyrat përkatëse nga një kompani e licencuar. Komuna kishte shpërblyer me kontratë OE pa e përmbushur këtë kriter, rastet janë si në vijim:

- Në dosjen e tenderit "Furnizimi me pajisje të fitnesit (outodor) dhe rregullimi i hapësirave fushore për vendosjen e tyre" operatori ekonomik (OE) i shpërblyer me kontratë nuk kishte ofruar pasqyrat e audituara për tri vite, por kishte ofruar vetëm një rishikim të pasqyrave financiare për vitin 2019. Pavarësisht kësaj, kontrata ishte nënshkruar me dt. 27.11.2020 në vlerë 14,958€; si dhe
- Në dosjen e tenderit "Furnizimi me uniforma (veshmbathje) për nevojat e drejtorive të SHCK-së" OE i shpërblyer me kontratë kishte ofruar pasqyrat e audituara vetëm për vitin 2019. Pavarësisht kësaj, kontrata ishte nënshkruar me dt. 29.12.2020 në vlerë 29,791€.

Shkak i parregullsive të tilla ishte neglizhenca e zyrtarëve kompetent për mbikëqyrje dhe vlerësim të ofertave.

Ndikimi

Shpërblimi me kontratë i operatorëve ekonomik pa i plotësuar të gjitha kriteret e vendosura në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë është kundërligjor dhe njëherësh vendosja e kriterit për të ofruar pasqyrat financiare të audituara ka ndikuar në kufizimin e konkurrencës, ku në të dy rastet kishin ofertuar vetëm OE fitues.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të siguroj përmes menaxherit të prokurimit se në procesin e vlerësimit të ofertave të respektohen plotësisht kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit duke siguruar që vetëm operatorët ekonomik që i përmbushin kriteret të shpërblehet me kontratë. Po ashtu me rastin e vendosjes së kriterëve të mos vendosen kriteret që ndikojnë në kufizim të konkurrencës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Tejkalim i sasive/ vlerës indikative të kontratës kornizë**Gjetja**

Sipas Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, neni 56.10 përcaktohet se: Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë +/- 30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht. Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë për qind (30%) vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull.

Komuna me dt.07.08.2019 kishte nënshkruar kontratën kornizë për Furnizim me material shpenzues mjekësor në kohëzgjatje për 36 muaj në vlerë totale indikative 44,300€ (furnizim me 45 artikuj/pozicione).

Te pagesa në shumë prej 7,902€ kemi konstatuar se në 8 pozicione/artikuj në shumë prej 2,316€ kishte tejkalim të sasisë për mbi 30%. Komuna me dt.11.12.2020 kishte lidhur kontratë tjetër me OE të njëjtë për "Furnizim me material shpenzues për QKMF dhe QMF" në vlerë 6,250€ (për furnizim me 23 artikuj/pozicione). Ne kemi vërejtur se nga 23 artikujt e përcaktuar për furnizim me këtë kontratë tetë (8) prej tyre veç ishin të përfshirë në kontratën e nënshkruar me dt.07.08.2019.

Kjo ka ndodhur si pasoj e mos komunikimit ndërmjet njësisë kërkuese dhe zyrës së prokurimit dhe neglizhencës së menaxherit të kontratës i cili për pagesë nuk sjell raport për sasinë e paguara deri në datën e pagesës po vetëm sasinë aktuale për pagesës.

Ndikimi

Tejkalimi i kontratës mbi normën e lejuar si dhe nënshkrimi i dy kontratave për furnizim me artikuj të njëjtë mund të ndikojë që organizata buxhetore të hyjë në obligime financiare të pa planifikuara.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të siguroj se gjatë realizimit të kontratave kornizë do të respektohen kriteret ligjore sa i përket tejkalimit të kuotave plus/minus tridhjetë për qind (30%) për pozicion/artikull. Në të kundërtën duhet të respektohet dispozita ligjore për ndërprerjen e kontratës kur ka devijim të sasisë apo vlerës mbi kuotën ligjore.

Më tutje, Kryetari duhet të sigurojë një komunikim/bashkëpunim më të mirë ndërmjet departamentit të prokurimit dhe njësisë kërkuese në mënyrë që të mos nënshkruhen dy kontrata për furnizim me artikuj të njëjtë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 568,110€, prej tyre ishin shpenzuar 471,545€. Komuna kryesisht ka mbështetur aktivitetet kulturore, sportive si dhe ka ndihmuar bujqit, fermerët dhe qytetaret në nevoje. Kemi testuar pesë (5) mostra për teste substanciale në vlerë 40,700€ si dhe tetë (8) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B4 - Dobësi në menaxhimin e subvencioneve

Gjetja

Sipas nenit 6 të Rregullores MF-Nr.04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve (Plani Vjetor i Mbështetjes Financiare) kërkohet: “Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit. Po ashtu, sipas nenit 11 paragrafi 1.5 përcaktohet që OJQ duhet ofrojnë dëshmi se kanë përvojë në realizimin e projekteve/ programeve të ngjashme.

Lidhur me këtë identifikua si në vijim:

- Komuna nuk ka përcjellë planin vjetor për financim të OJQ-ve në ZKM, pasi që vetëm drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport kishte përgatitur pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare, kurse Drejtorit tjera të cilat ofrojnë mbështetje financiare për OJQ-të, kishin dështuar në përgatitjen e planit vjetor. Shkak i kësaj ishte neglizhenca e drejtorive për përgatitjen e planit vjetor të mbështetjes financiare;
- Komuna për “Dezinfektim të objekteve komunale” kishte subvencionuar një OJQ në vlerë 9,800€. OJQ-ja nuk kishte ofruar dëshmi se kishte përvojë në ofrimin e shërbimeve të tilla. Më tutje, nga kjo pagesë vetëm 5,800€ janë shpenzuar për dezinfektim kurse pjesën tjetër (4,000€) OJQ i kishte shpenzuar për paga, dreka, telefon dhe transport. Sipas zyrtarëve kjo ka ndodhur për shkak të emergjencës së krijuar nga pandemia COVID-19.

Ndikimi

Mos përgatitja e planit vjetor rrit rrezikun që mjetet buxhetore të shfrytëzohen për qëllime tjera të paplanifikuara si dhe subvencionimi i OJQ në mungesë të dëshmive për realizimin e projekteve të ngjashme ndikon në cilësinë e realizimit të projektit.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të siguroj se, drejtoritë përkatëse përgatisin plan vjetor për subvencionim të OJQ-ve dhe se ndarja e buxhetit bëhet në përputhje me objektivat e përcaktuara duke respektuar kriteret e rregullores për subvencionim të OJQ-ve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 10,511,926€, prej tyre ishin shpenzuar 9,708,932€. Këto shpenzime kryesisht kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve, kanalizimeve, trotuareve, ndërtimin e objekteve, blerje të pajisjeve etj. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 4,223,814€, si dhe tetë (8) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B5 - Menaxhim i dobët i kontratave

Gjetja

Sipas nenit 81 të Ligjit për Prokurim Publik si dhe Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurimin publik pika 61.6, 61.19 dhe 61.20, menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë, ku janë të përcaktuar afatet kohore të implementimit të saj. Po ashtu sipas Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik neni 30 (Siguria e Ekzekutimit) pika 30.6 përcakton se "Siguria e Ekzekutimit është paraparë të mbështetë përmbushjen e kontratës, dhe mbetet valide për një periudhë prej 30 ditë pas kompletimit të kontratës.

- Te kontrata për ndërtimin e shkollës së muzikës "Halil Kasapoli" në Pejë – faza e dytë, e nënshkruar me datë 28.06.2018 në vlerë 467,578€, punimet nuk ishin realizuar sipas planit dinamik siç parashihet me kontratë. Sipas planit dinamik punimet është dashur të përfundojnë më 31.12.2019, megjithatë punimet ende nuk kishin përfunduar dhe kontrata ishte ende aktive. Po ashtu komuna nuk kishte vazhduar sigurimin e ekzekutimit krahas vonesave të shkaktuara në realizimin e punimeve.
Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së mjeteve shtesë në dispozicion si nevojë e paraqitur për shkak të planifikimit jo të duhur të projektit si edhe fatkeqësitë natyrore ku gjatë procesit të punëve kanë ndodhur vërshime. Kurse shkak i mos vazhdimit të sigurimit të ekzekutimit ishte pakujdesia dhe neglizhenca nga zyrtarët kompetent.

Në dy raste pagesat ishin realizuar për punët e pa kryera, si në vijim:

1) Kontrata "Lot 3 Renovimi i shkollës 7 Shtatori në fshatin Vitomericë" e nënshkruar me dt.12.06.2020 në vlerë prej 52,744.90€, vlera e pagesave për punë të pa realizuar ishte 1,900€ si më poshtë:

- Pozicioni 1-Furnizimi dhe montimi i një (1) derë me dimensione 300x315cm; sipas situacionit të nënshkruar nga organi mbikëqyrës është realizuar pozicioni, ndërsa nga ekzaminimi fizik ky pozicion ishte i pa realizuar (vlera e punëve të përfunduar 500€);
- Pozicioni 2-Furnizimi dhe montimi i dy (2) dyerve me dimensione 220x315cm; sipas situacionit të nënshkruar nga organi mbikëqyrës është realizuar pozicioni, ndërsa nga ekzaminimi fizik ky pozicion ishte i pa realizuar (vlera e punëve të përfunduar 800€);
- Pozicioni 3-Furnizimi me material, transporti dhe vendosja e dyerve PVC me ngjyre të bardhë me dimensione 70/210cm; sipas situacionit të nënshkruar nga organi mbikëqyrës janë realizuar tetë (8) njësi nga ky pozicion, ndërsa nga ekzaminimi fizik konstatuam vetëm katër (4) njësi të realizuara (vlera e punëve të përfunduar 600€).

2) Kontrata “Rregullimi – kubëzimi i trotuarit në lagjen e Gjinnazit” e nënshkruar me dt.03.09.2020 në vlerë prej 37,870€, vlera e pagesave për punë të pa realizuar ishte 2,730€ si më poshtë:

- Pozicioni 3.2-Heqja e gurëve skajor ekzistues të dëmtuar dhe bartja e tyre deri në deponin me të afërt. Furnizim me material dhe vendosja e gurëve skajor prej betoni të markës C-35/45, për kufizimin e kubëzave në vende të caktuara në projekt me dimensione 15x25x100cm në bazament prej betoni me trashësi prej 15cm gjithnjë sipas rregulloreve EN 1340 për këtë dimension, pozicioni përfshin të gjitha testimet (edhe testimet e ngjeshmërisë); sipas situacionit të nënshkruar nga organi mbikëqyrës janë realizuar 750 njësi nga ky pozicion, ndërsa nga ekzaminimi fizik rezultojnë vetëm 106 njësi të realizuara (vlera e punëve të përealizuara 322€);
- Pozicioni 3.3-Furnizim me material dhe vendosja e gurëve skajor prej betoni të markës C-35/45, për kufizimin e kubëzave në vende të caktuara në projekt me dimensione 10x25x100cm në bazament prej betoni me trashësi prej 15cm gjithnjë sipas rregulloreve EN 1340 për këtë dimension, pozicioni përfshin të gjitha testimet (edhe testimet e ngjeshmërisë); sipas situacionit të nënshkruar nga organi mbikëqyrës janë realizuar 550 njësi nga ky pozicioni, ndërsa nga ekzaminimi fizik rezultojnë 249 njësi të realizuara (vlera e punëve të përealizuara 2,408€).

Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxheret e kontratave/projekteve kishin nënshkruar raportet që punët janë përfunduar sipas kushteve të kontratës, përderisa ato nuk ishin kryer. Si dhe mungesa e projekteve ekzekutive dhe mos përshtatja e kërkesave të terrenit me sasi të planifikuara në paramasë.

Ndikimi

Vonesat në realizimin e kontratave rrisin rrezikun që obligimet kontraktuale të barten për tu paguar në vitet e ardhshme, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e viteve pasuese. Ndërsa implementimi i kontratës në mungesë të sigurisë së ekzekutimit rrit rrezikun që humbjet eventuale për realizimin e projektit të mos mbulojnë nga OE dhe në rast kontesti për mos përmbushjen e kontratës komuna rrezikon të pranojë punime në sasi dhe cilësi të ulët. Më tutje pagesa për punë të pakryera ndikon në dëmtim të buxhetit.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të shtojë kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve në mënyrë që ato të përfundohen sipas planit dinamik dhe të mos hyjnë në obligime pa mbulesë financiare. Më tutje, duhet të sigurojë që për të gjitha kontratat krahas vonesave në realizimin e punimeve të zgjatet edhe siguria e ekzekutimit. Po ashtu, kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherëve të kontratave që në raportin e pranimit të përfshihen vetëm punët e realizuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Shpërblimi me kontratë në mungesë të përmbushjes së kriteve të vendosura në dosje të tenderit**Gjetja**

Sipas ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 65 paragrafi 4.8 "Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatimin në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë.

Tek procedura e prokurimit "Ndërtimi i kanaleve atmosferike dhe fekale LOT 1 – Ndërtimi i kanalit atmosferik në lagjen 2 Korriku, Xhemajl Kada dhe Asllan Qeshme", vlera e kontratës: 47,339€ , kishte shpërblyer ofertuesin me kontratë përkundër që i njëjti nuk kishte përmbushur kriterin 3.2.1 të përshtatshmërisë "Vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore". Operatori Ekonomik kishte dorëzuar dëshminë e vërtetimit tatimor i cili mbante datën 20.04.2020, mirëpo pas verifikimit konstatuam se i njëjti ishte lëshuar nga moduli i ATK-së me datë 25.04.2019. Ky fakt nuk ishte verifikuar dhe vërejtur nga ana e zyrtarëve të prokurimit.

Shkaku i një lëshimi të tillë ishte neglizhenca e zyrtarëve të prokurimit në vlerësimin dhe verifikim të plotë të dokumentacionit i cili ishte dorëzuar nga OE.

Ndikimi

Shpërblimi me kontratë pa u përmbushur kriteret e kërkuara shton rrezikun e kontraktimit të operatorëve ekonomik të pa përgjegjshëm që do të ndikoj në cilësi të dobët të punëve, po ashtu, dëmton transparencën dhe eliminon konkurrencën.

Rekomandimi A5

Kryetari të siguroj kontrole të shtuara në mënyrë që të bëhet vlerësim i drejtë i ofertave dhe të respektohen plotësisht kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit duke siguruar që vetëm operatorët që i përmbushin kriteret të shpërblehet me kontratë. Më tutje, lidhur me rastin e cekur më lartë të iniciohet procedura ligjore ndaj OE sipas legjislacionit përkatës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A6 - Mangësi në procedimin e pagesave****Gjetja**

Rregulla financiare Nr.01/2013 përcakton që fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, më pas zotimi i mjeteve, të procedohet urdhër-blerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimin të faturës të ekzekutohet pagesa.

Në 13⁷ raste faturat në vlerë 799,407€ së bashku me situacionin mbështetës ishin pranuar nga komuna para datës së kërkesës për zotim të mjeteve dhe kërkesës për investime kapitale.

Shkak i kësaj ishte mos komunikimi në mes njësisë kërkuese, zyrtarit për pranimin e faturave dhe zyrtarëve të pranimin të punëve/mallrave.

Ndikimi Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme ka ndikuar në krijimin e obligimeve të cilat e rëndojnë buxhetin e vitit pasues.

Rekomandimi A6 Kryetari të siguroj se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet malli/shërbimi dhe të kryhet pagesa.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Investime publike në parcelat e pa shpronësuara

Gjetja Sipas nenit 4.2 të Ligjit nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme- “Organi Shpronësues i Komunës është kryetari i Komunës, përveç nëse Kuvendi Komunal i Komunës përkatëse, përmes një akti të miratuar në përputhje me nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, cakton një Autoritet tjetër Publik Komunal për të vepruar në cilësinë e Organit Shpronësues të Komunës”. Neni 4 pika 2.4.3.1 përcakton se “Organi Shpronësues i Komunës mund të bëjë shpronësimin e pronës së paluajtshme vetëm nëse ndërlihet me rrugët komunale (rrugët të cilat shtrihen tërësisht brenda komunës) të cilat ofrojnë shërbime të transportit për publikun”.

Komuna në dy⁸ raste investimet publike përkatësisht asfaltimin e rrugëve e kishte realizuar në prona private të pa shpronësuara. Komuna përpos që në raste të caktuara kishte marrë pëlqim jo formal nga pronarët e tokave për të realizuar investimin, nuk kishte ndërmarrë asnjë procedurë ligjore që pronat në të cilat po kryhen investimet të kthehen në pasuri të komunës sikur edhe parashihet me ligjet në fuqi.

Sipas zyrtarëve të komunës nëse do të zhvilloheshin procedura të shpronësimit do të pamundësohej realizimi i investimeve për shkak të dinamikës në procedurat e shpronësimit dhe se kanë marrë pëlqimin e banorëve për kryerjen e punëve në pronat e tyre.

Ndikimi Realizimi i projekteve të tilla rrit rrezikun që komuna të përballet me padi në të ardhmen nga pronarët e parcelave, ku përveç kompensimit të shpronësimit do të shkaktohen edhe shpenzime tjera shtesë.

Rekomandimi A7 Kryetari duhet të sigurojë se bëhet shpronësimi i pronave private para investimit/ndërtimit të rrugëve dhe kjo të trajtohet në bazë të dispozitave ligjore para inicimit të tenderimit për ekzekutim të projekteve kapitale - ndërtim/zgjerim të rrugëve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.5 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 339,895,117€, pasurive jokapitale është 339,830€, si dhe e stoqeve 343,017€. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 3,459,971€ si dhe pesë (5) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B6 - Mangësi në regjistrat kontabël të pasurive

Gjetja Sipas nenit 6.3 të Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë financiare- "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria.

Lidhur me këtë kemi identifikuar mangësit në vijim:

- Në regjistrin e pasurisë SIMFK në katër⁹ raste nuk ishte regjistruar vlera e shpronësimit të tokave në shumën prej 388,027€.

- Tek projekti "Montimi i pajisjeve të kuzhinës në çerdhen "Pëllumbat e Paqes" pagesa në vlerë 58,467€ nuk ishte regjistruar në regjistrat e pasurisë. Prej tyre 31,581€ janë pasuri mbi 1,000€, ndërsa 26,886€ janë pasuri nën 1,000€.

- Po ashtu në regjistrin e e-pasurisë në gjashtë⁹ raste komuna nuk kishte regjistruar pasurinë në vlerë prej 4,444€.

Mos regjistrimi i pasurisë në SIMFK dhe e-pasuri sipas zyrtarëve ka ndodhur si pasojë e mos komunikimit në mes të zyrtarëve të pagesave dhe pasurisë.

Ndikimi Regjistri jo i plotë i pasurive, rezulton me mangësi informatash për pasuritë dhe raportim jo të drejtë të tyre. Po ashtu, rrit rrezikun e humbjes dhe tjetërsimit të tyre.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të sigurojë se, zyrtari i pasurisë bën regjistrimin e plot të pasurisë jo financiare dhe mirëmban regjistrat e pasurisë që disponon komuna.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.6 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2020 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 18,810,302€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë 12,171,825€, taksa në ushtrim të veprimtarisë 6,391,030€, kërkesa nga paditë në gjyq 146,990 qiratë 57,976€, parkingu 41,659€, dhe çerdhja 821€.

Çështja B7 - Rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Komuna nuk ka arritur të përgatit një plan operativ për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme dhe nuk ka ndërmarr veprimet e kërkuara sipas legjislacionit.

Llogaritë e arkëtueshme krahasuar me vitin e kaluar janë rritur për 871,951€ (apo në masën prej 5%), rritja më e madhe ka ndodhur te tatimi në pronë si dhe tek pronat e dhëna me qira.

Shkaqet e rritjes së të arkëtueshmeve janë veprimi i pamjaftueshëm i komunës, që përmes organeve të drejtësisë të zvogëlojë borxhin e pa mbledhur nga klientët.

Ndikimi Rreziku i mos arkëtimit të të hyrave ndikon në dëmtimin e buxhetit të komunës. Mungesa e kontrollit dhe mos veprimi i komunës pamundëson arkëtimin dhe rrit rrezikun e vjetërimit të llogarive të arkëtueshme

Rekomandimi B7 Kryetari duhet të siguroj një plan veprimi për mbledhjen e borxheve. Fillimisht duhet të intensifikohen aktivitetet përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbauesve për ulje të llogarive të arkëtueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ¹⁰	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	28,545,319.00	31,243,955.22	29,725,919.88	26,583,241.01	24,804,411.40
Grante Qeveritare – Buxheti	24,195,724.00	24,846,804.76	24,642,123.45	21,394,389.49	20,777,769.53
Financimi përmes huamarrjes	0.00	191,665.00	186,281.85	66,731.34	0.00
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	655,575.20	579,274.22	702,297.73	224,264.11
Të hyrat vetanake	4,349,595.00	4,349,595.00	3,320,699.85	3,959,760.02	3,546,913.89
Donacionet vendore	0.00	59,891.30	27,000.00	45,600.00	17,590.99
Donacionet e jashtme	0.00	1,140,423.96	970,540.51	414,462.43	237,872.88

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,698,634€. Kjo rritje është rezultat i rishikimit të buxhetit, të hyrave të bartura nga viti paraprak, rritjes së grantit qeveritar, donacioneve vendore dhe financimit nga huamarrja.

Në vitin 2020, komuna ka shpenzuar 95% të buxhetit final ose 29,725,920€, krahasuar me vitin 2019 kemi një realizim po thuajse të njëjtë të buxhetit (2019 - 96%). Realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	28,545,319.00	31,243,955.22	29,725,919.88	26,583,241.01	24,804,411.40
Pagat dhe mëditjet	14,341,566.00	14,738,438.04	14,686,861.99	13,777,194.28	13,644,055.90
Mallrat dhe shërbimet	3,294,859.00	4,667,793.29	4,132,109.01	3,015,539.22	2,834,089.55
Komunalitë	751,924.00	757,687.62	726,471.17	729,989.38	706,617.99
Subvencionet dhe transferet	443,000.00	568,110.48	471,545.35	334,878.40	300,260.35
Investimet Kapitale	8,000,891.00	10,511,925.79	9,708,932.36	8,725,639.73	7,319,387.61
Rezervat	1,713,079.00	0.00	0.00	0.00	0.00

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 396,870€ kjo rritje ishte rezultat i vendimeve të Qeverisë në shumë prej 156,030€, granateve të përcaktuara të donatoreve 62,550€ dhe financimeve nga huamarrjet në shume prej 178,290€.

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 1,372,934€, kjo rritje ishte rezultat i vendimeve të Qeverisë në shumë prej 860,978€, rishikimit të buxhetit në shumë prej 270,886€, të hyrave të batuara nga viti i kaluar në shume prej 6,230€, granateve të përcaktuara të donatoreve 234,840€.

Buxheti final për shërbimet komunale ishte rritur për 5,764€ si rezultat i të hyrave të batuara nga viti i kaluar.


Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 125,110€, si rezultat i vendimeve të Qeverisë në shumë 75,000€, rishikimit të buxhetit në shumë prej 50,000€ dhe të hyrave të bartura në shumë 110€.

Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,511,035€, kjo rritje ishte rezultat i vendimeve të Qeverisë në shumë prej 879,560€, rishikimit të buxhetit në shumë prej 85,075€, të hyrave të batuara nga viti i kaluar në shume prej 643,470€, granateve të përcaktuara të donatoreve 902,930€.


Buxheti final për rezerva në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,713,079€ buxhet i cili ka kaluar në kategori tjera me vendime dhe rishikim të buxhetit.

Komuna për menaxhimin e pandemisë Covid-19 kishte shpenzuar buxhet në vlerë prej 901,420€, prej tyre 644,910€ ishin për shtesa në paga si dhe 256,510€ mallra dhe shërbime.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Komuna për vitin 2020 kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 4,349,600€, nga të cilat ishin realizuar 3,460,290€ apo 80%. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	4,349,595.00	4,349,595.00	3,470,295.87	3,825,001.68	3,590,491.49
Të hyrat tatimore	2,381,752.00	2,381,752.00	1,412,090.67	1,934,045.96	1,557,377.90
Të hyrat jo tatimore	1,967,843.00	1,967,843.00	2,048,205.20	1,890,955.72	2,032,123.59
Të hyrat tjera	0.00	0.00	10,000.00		990.00

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të Komunës së Pejës ka rezultuar në 15 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Po ashtu kishte bërë monitorim të zbatimit të rekomandimeve ku ishte përgatitur një raport monitorimi.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, gjashtë rekomandime janë zbatuar, shtatë rekomandime nuk ka filluar zbatimin dhe dy rekomandime nuk janë të aplikueshme, siç është paraqitur në Grafikon 4, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari i komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestnimi i mjeteve sipas kërkesave ligjore dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë strikte sipas kategorive ekonomike adekuate. Kryetari duhet të sigurojë që para krijimit të obligimeve fondet janë të buxhetuara dhe mjetet janë të zotuar me qëllim të forcimit të disipline financiare për pagesën e obligimeve me kohë dhe evitimin e ballafaqimit me drejtësinë duke eliminuar edhe pasojat apo mundësin e	Kjo çështje do të trajtohet në Raportin Vjetor të Auditimit.	Nuk është i aplikueshëm më

		shpenzimeve shtesë.		
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se ndërmerren aktivitetet e nevojshme sipas rregullave për lidhjen e kontratave me kohë për shpenzimet që kërkojnë prokurim dhe menaxherët e projekteve të veprojnë në pajtueshmëri me LPP dhe Rregullat e udhëzuesit operativ për prokurimin publik për ndryshimet e kushteve dhe termeve të kontratës. Në të kundërtën duhet të respektohet dispozita ligjore për ndërprerjen e kontratës kur ka devijim të sasisë apo vlerës mbi kuotën ligjore.	Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatim
3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që aplikohen procedurat adekuate të prokurimit dhe shërbimet e sigurimit të kontraktohen me kompanitë që plotësojnë kriteret e përcaktuar ligjore të cilat janë të licencuara dhe të autorizuara në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-004	Gjendja është e njëjtë për kontratën në fjalë pasi që nuk mund të bëhen ndryshime retroaktive për kontratën në fjalë dhe se gjatë vitit 2020 nuk kemi identifikuar raste të reja.	Nuk është i aplikueshëm më
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari, duhet të siguroj ndërprerjen e një praktike të tillë të angazhimeve pa procedura të rekrutimit. Po ashtu, komuna për pozitat e rregullta të punës për të cilat ka nevoja afatgjata kërkesat të trajtoj dhe diskutuar me MF dhe t'i adresoj me rastin e planifikimit të buxhetit.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur raste të tilla.	I zbatuar
5.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj se, drejtoritë përkatëse përgatisin plan vjetor për subvencionim të OJQ-ve dhe se ndarja e buxhetit bëhet në përputhje me objektivat e përcaktuara.	Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatim
6.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj që në planifikim të buxhetit përfshihen të gjitha projektet që ekzistojnë mundësitë reale të realizohen dhe të ndahet buxhet i mjaftueshëm për realizimin e tyre. Gjithashtu, kontrollet duhet të jenë funksionale edhe në fazën e realizimit të projekteve, duke u siguruar paraprakisht se hyrja në obligime kontraktuale është në përputhje me planifikimin e aprovuar dhe ka mjaftueshëm fonde të zotuar për realizimin e pagesave. Nëse paraqitet nevoja për ri destinim të mjeteve të sigurohet miratimi paraprak i Kuvendit Komunal.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur raste të tilla.	I zbatuar
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve janë pajisur me njohuri lidhur me kërkesat specifike për prokurim publik, dhe raportohet për çdo devijim nga termat dhe kushtet e kontratës. Po	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur raste të tilla.	I zbatuar

		ashtu, çdo ndryshim në kushtet e kontratës duhet të arsyetohet në detaje nga menaxheri i projektit, përgatitet nga prokurimi dhe aprovohet nga ZKA.		
8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj kontrole dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore që me rastin e kontraktimit të punëve duhet të sigurohet paraprakisht projektet që janë hartuar në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara. Sigurimi i projektit ekzekutiv duhet të shërbej si bazë për fillimin e procesit, zhvillimin e prokurimit dhe kontraktimit të punëve, në të kundërtën fillimi i procesit të prokurimit nuk është i lejuar sipas ligjit. Parapërgatitjet e duhura për një projekt do të kenë efekt në hartimin e specifikimeve të qarta, duke eliminuar pengesat si të vonesave ashtu edhe të kostove shtesë.	Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e kontratave në raportet e tyre ofrojnë informata të mjaftueshme rreth ecurisë së zbatimit të kontratave dhe të formalizojnë procesin e shtyrjes së afateve kur ato janë të justifikuar nga ana e komunës. Po ashtu, duhet të shtohen masat e kontrollit dhe në rastet kur ka vonesa të pa arsyetuara të aplikohen penalet për ditët në vonesë dhe shtohen kontrollet që pagesat të realizohen vetëm atëherë kur punët vërtet janë pranuar.	Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
10.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të siguroj se bëhet planifikim i mirëfilltë i buxhetit, duke forcuar disiplinën financiare për kryerjen e pagesave me kohë dhe të marr masat e duhura për menaxhimin obligimeve për të evituar proceset gjyqësore të cilat bartin shpenzime shtesë.	Rekomandim i zbatuar	I zbatuar
11.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë kontrole shtesë, në mënyrë që kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde që sigurojnë realizimin e plotë të tyre, pa marrë parasysh nëse financimi i tyre është nga të hyrat vetjake apo fondet tjera të financimit.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur raste të tilla.	I zbatuar
12.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të duhet të rishikojë arsyet për dështimin e kontrolleve dhe të marrë masa dhe veprime për forcimin e tyre, në mënyrë që të gjitha aktivitetet e prokurimit të zhvillohen në përputhje të plotë me kërkesat e LPP-së. Periudha e vlefshmërisë së sigurimit mbi ekzekutimin e kontratës duhet të zbatohen sipas ligjit.	Rekomandim i zbatuar	I zbatuar
13.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurohet që menaxhimi i pasurisë jo financiare bëhet në përputhje me Rregulloren 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare dhe të siguroj se të gjitha pasuritë e komunës	Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij	Nuk ka filluar zbatimin

		janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale dhe janë prezantuar drejt me vlerë neto në PFV.	rekomandimi.	
14.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë që shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet kontraktuale	Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
15.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të ngritë kontrolle shtesë për tu siguruar se të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda afatit të paraparë ligjor me qëllim të menaxhimit të obligimeve të papaguara.	Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj që thirrjet publike për subvencionim të përmbajë të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregulloren mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve, pastaj ndarja e subvencioneve të bëhet në përputhje me kriteret e vendosura si dhe për çdo përfitues të subvencionit të caktojë zyrtar monitorues.
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtëshme në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës.
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se dosjet e tatimpaguesve janë kompletuar bazuar në kërkesat e sistemit Protax.
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari i Komunës duhet të siguroj përmes menaxherit të prokurimit se në procesin e vlerësimit të ofertave të respektohen plotësisht kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit duke siguruar që vetëm operatorët ekonomik që i përmbushin kriteret të shpërblehet me kontratë. Po ashtu me rastin e vendosjes së kriterëve të mos vendosen kriteret që ndikojnë në kufizim të konkurrencës.
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të siguroj se gjatë realizimit të kontratave kornizë do të respektohen kriteret ligjore sa i përket tejkalimit të kuotave plus/minus tridhjetë përqind (30%) për pozicion/artikull. Në të kundërtën duhet të respektohet dispozita ligjore për ndërprerjen e kontratës kur ka devijim të sasisë apo vlerës mbi kuotën ligjore. Më tutje, Kryetari duhet të sigurojë një komunikim/bashkëpunim më të mirë ndërmjet departamentit të prokurimit dhe njësisë kërkuese në mënyrë që të mos nënshkruhen dy kontrata për furnizim me artikuj të njëjtë.
6.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj se, drejtoritë përkatëse përgatisin plan vjetor për subvencionim të OJQ-ve dhe se ndarja e buxhetit bëhet në përputhje me objektivat e përcaktuara duke respektuar kriteret e rregullores për subvencionim të OJQ-ve.
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj kontrolle dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore që me rastin e kontraktimit të punëve duhet të hartohen paraprakisht projektet ekzekutive në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara të njësisë kërkuese.
8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të shtojë kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve në mënyrë që ato të përfundohen sipas planit dinamik dhe të mos hyj në obligime pa mbulesë financiare. Më tutje, duhet të siguroj që për të gjitha kontratat krahas vonesave në realizimin e punimeve të zgjatet edhe siguria e ekzekutimit. Po ashtu, kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherëve të kontratave që në raportin e pranimit të përfshihen vetëm punët e realizuara.

9.	Investimet kapitale	Kryetari të siguroj kontrolle të shtuara në mënyrë që të bëhet vlerësim i drejtë i ofertave dhe të respektohen plotësisht kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit duke siguruar që vetëm operatorët që i përmbushin kriteret të shpërblehet me kontratë. Më tutje, lidhur me rastin e cekur më lartë të inicohet procedura ligjore ndaj OE sipas legjislacionit përkatës.
10.	Investimet kapitale	Kryetari të siguroj se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet malli/shërbimi dhe të kryhet pagesa.
11.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se bëhet shpronësimi i pronave private para investimit/ndërtimit të rrugëve dhe kjo të trajtohet në bazë të dispozitave ligjore para inicimit të tenderimit për ekzekutim të projekteve kapitale - ndërtim/zgjerim të rrugëve.
12.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se, zyrtari i pasurisë bën regjistrimin e plot të pasurisë jo financiare dhe mirëmban regjistrat e pasurisë që disponon komuna.
13.	Llogaritë arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj një plan veprimi për mbledhjen e borxheve. Fillimisht duhet të intensifikohen aktivitetet përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbaruesve për ulje të llogarive të arkëtueshme.
14.	Obligimet papaguara	Kryetari duhet të ngritë kontrolle shtesë për tu siguruar se të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda afatit të paraparë ligjor me qëllim të menaxhimit të obligimeve të papaguara.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm




Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Arian Haxha, Udhëheqës i Auditimit



Fanol Hodolli, Udhëheqës i ekipit



Hysen Restelica, Anëtar i ekipit




Arian Zenelaj, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

Leter konfirmimi



Komuna e Pejës

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **Komunës së Pejës**, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- **pajtohem/ nuk pajtohem/ pajtohem pjesërisht/ me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe**
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Gazmend Muhaxheri

(Kryetar i Komunes së Pejës)

Data 15/07/2021



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare¹¹ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.¹² Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- 1 Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- 2 Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- 3 Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- 4 Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- 5 1.1. udhëzimet e thirrjes për aplikantët, duke përfshirë kriteret për përzgjedhjen e përfituesve; 1.2. formularin për përshkrimin e projektit/programit; 1.3. formularin e buxhetit; 1.4. listën e plotë të dokumenteve të nevojshëm për t'u paraqitur në thirrje; 1.5. datën e hapjes dhe mbylljes së thirrjes; 1.6. të dhëna për mënyrën e dorëzimit të aplikacioneve; dhe 1.7. të dhëna për kalendarin tentativë të realizimit të thirrjes dhe kontraktimit.
- 6 “Ndertimi i katër urave mbi shtratin e lumit Lumbardh” vlera kontratës 99,962€ nënshkruar më 28.12.2020 dhe “NdertimiNdërtimi i kanaleve atmosferike dhe fekale, Lot 1 – NdertimiNdërtimi i kanalit atmosferik në lagjen 2 Korriku , Xhemajl Kada dhe Asllan Qeshme” vlera e kontratës 47,339€, nënshkruar më 01.06.2020; “Ndertimi i katër urave mbi shtratin e lumit Lumbardh” vlera kontratës 99,962€ nënshkruar më 28.12.2020 dhe “NdertimiNdërtimi i kanaleve atmosferike dhe fekale, Lot 1 – NdertimiNdërtimi i kanalit atmosferik në lagjen 2 Korriku , Xhemajl Kada dhe Asllan Qeshme” vlera e kontratës 47,339€, nënshkruar më 01.06.2020. “Ndërtimi i rrugës Dogan – Rusoli – Shtedim në Komunën e Pejës” Vlera e kontratës 1,491,036€, nënshkruar me dt.30.09.2020, dhe “Ndërtimi i rrugës Maja e ,Zezë – Vitomeric” 1,192,260€, nënshkruar me dt.23.09.2020.
- 7 #635201003 ASF.RRUG.FSH.TRESTENIK, RUHOT DHE LUTOGLLAV 635-19-7432-5-1; vlera 67,308.00€, #635200402 NDERTIMI I SHKOLLES SE ARTIT FAZA II, vlera 23,866.64€; #63520A0110 NDERTIMI I QERDHESE SE FEMIJEVE NE LAGJEN KARAGAÇ 635-19-3758-5-2-1, vlera 59,700.00€; #635201074 ASF.RR.FSH.QYSHK BLAG.KAT.I RI DHE TREBOVIQ, vlera 85,584.75€; #635201073 ASF.RR.FSH.NABERGJAN, vlera109,569.50€; #635200470 ASF.RR.FSH.KLIQIN, JABLL.E LESHANIT, ROSUJ, GLLAVIQICE DHE SFERKE 635-19-7432-5-1-1, vlera 80,918.25€; #635200097 ASF.I RR.QAMERIJA vlera36,864.00€; #635200820 ASF.I RR.NE FSH.RAUSH. DRUM. TEL.LUB. DHE RR.S.QEKU-LOT, vlera 95,992€; #635202786 ASF.I RRUG.NE FSHATRAT TRESTENIK, RUHOT DHE LUTOGLLAV 635-19-7432-5-1-1, vlera 25,000.00€; #635200815 ASF.I RR.NE FSH.ZAHAQ LLABJ.PAV DHE RAMUN, vlera76,488.00€; #635200819 ASF.I RRUG.NE FSH.ZLLOPEK DHE VITOMERICE 635-19-3746-5-2-1, vlera 45,655.50€; #635200886 ASF.I RRUGEVE NE FSH.ZAHAQ, LLABJAN, PAVLAN DHE RAMUN 635-19-7432-5-1-1, vlera 41,881.79€; #635200433 ASFALT. I RRUGEVE NE POQESTE, GLLAVIQICE, SVERK E THATE, DHE BROLIQ 635-19-4535-5-2-1, vlera 50,579.00€
- 8 LOT 2 – Asfaltimi i rrugeve ne fshatrat Glllogjan, Nepole, Llugagji dhe Kosuriq, vlera 210,117€; LOT1- Asfaltimi i rrugës ne fshatin Nabërgjanë, vlera 275,013€
- 9 Shpronësim: MEDIHA BEQIRI, 145,680€; VISAR MUSLIU 100,839€; NEXHAD KASAPOLLI 68,568€; BLERIM AVDIJAJ, 72,940 €; Furnizimi me inventar për zyre –LOT 2, vlera pageses:1,000€; Blerja e mjeteve të teknologjisë, vlera pagesës: 1,296€; Avanci në vlera: 99€, 79€, 96€; Blerja dhe vendosja e perdeve, vlera pagesës 386€, Mirmbajtja, servisimi dhe furnizimi për sistemin e kanalizimit, sanitarisë dhe ngrohjes në objektet e SHCK-së, vlera pagesës: 620€ dhe Blerja dhe vendosja e perdeve, vlera: 868€
- 10 Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- 11 Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- 12 Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.